

**URDHËR**  
**Nr. 148, datë 31.10.2025**

**PËR RAPORTIMIN E TË DHËNAVE DHE ECURISË SË ÇËSHTJEVE**  
**GJYQËSORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS)”,

**URDHËROJ:**

1. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore pranë MTKS-së, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, raportojnë të dhënat për çështjet gjyqësore që kanë në ndjekje, duke pasqyruar nëpërmjet një format tablele:

- a) numrin e çështjes në regjistrin elektronik të ministrisë/institucionit të varësisë;
- b) numrin e aktit;
- c) palët ndërgjyqëse;
- d) objektin e çështjes;
- e) gjykatën dhe gjyqtarin/gjyqtarët aktual të çështjes;
- f) ecurinë e gjykimit dhe zhvillimet gjatë seancave përgatitore/gjyqësore;
- g) planifikimin e gjykimit dhe fazën procedurale pasardhëse;
- h) rezultatin e çështjes (dispozitivi i vendimit, numri dhe data e vendimit);
- i) klasifikimin e çështjes sipas kodit “A”;
- j) problematika të evidentuara gjatë gjykimit;
- k) dëmin e parandaluar apo të shkaktuar (në vlerë dhe në sipërfaqe m<sup>2</sup>);
- l) datën e ankimit/rekursit;
- m) informacionin e shkurtuar të rezultatit të çështjes (fituar, humbur, fituar pjesërisht, jashtë juridiksioni, jashtë kompetence, pushuar, pezulluar, kthim aktesh, rigjykim, deleguar, relatuar).

2. Raportimi kryhet sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri, dhe informacioni i shkurtuar pasqyrohet sipas përcaktimit në shkronjën “m”, të pikës 1 të këtij urdhri.

3. Në çështjet gjyqësore në të cilat kërkohet “marrja e masës së sigurimit të padisë” apo “sigurimi i provës”, të cilat kanë afate të shkurtra kohore, raportohet menjëherë me marrjen në dijeni të tyre pranë Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit të caktuar për koordinimin e mbrojtjes me Avokaturën e Shtetit.

4. Tabela bashkëlidhur këtij urdhri do të përmbajë informacionin për të gjitha çështjet gjyqësore të ndjekura brenda një viti pune dhe do të përsëritet në fillim të çdo viti, duke pasqyruar çështjet e mbartura, të ankimuara dhe çështjet e reja. Numri rendor i çështjeve në tabelën raportuese duhet të mbetet i njëjtë deri në fund të vitit.

5. Juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë dhe/ose degët e tyre territoriale, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit tabelën e raportimit çdo ditë të premte të javës, duke përditësuar ecurinë gjatë javës dhe planifikimin për javën pasardhëse. Në rastet kur e premtja është ditë feste zyrtare, raportimi duhet të kryhet ditën pararendëse.

6. Brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, juristët e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore dhe Gjyqësore, si dhe nëpunësit përgjegjës për përfaqësimin ligjor në institucionet e varësisë

dhe/ose degët e tyre territoriale, dërgojnë në adresat zyrtare elektronike të Sekretarit të Përgjithshëm të MTKS-së dhe personit të kontaktit, raportim të detajuar mbi ecurinë e të gjitha çështjeve të mbartura, në proces dhe të përfunduara gjatë muajit, dhe planifikimin për secilën çështje.

7. Ngarkohen të gjitha strukturat e aparatit të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, dhe institucionet në varësi të saj, për zbatimin e këtij urdhri, si dhe Sektori i Arkiv/Protokollit për komunikimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
**Blendi Gonxhja**